



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KHOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIE - MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE - MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY	
Nr. Prot. Org. / Prot. No.	01 / 6167
Nr. F. / No.	2 / 11.09.2020

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry
Kabineti i Ministrit - Kabinet Ministra - Cabinet of the Minister

01.Ref.Nr.24
Prishtinë, 11.09.2020

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, në mbështetje të nenit 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr.7/01 Mars 2019), Ligjin Nr.06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe nenin 8, paragrafi 1.4 i Rregullores (QRK) Nr. 06/2020 Për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

VENDIM

1. Ndalohet përkohësisht importi i vajit të palmës, dhe importi i djathit dhe produkteve të ngjashme të djathit të prodhuara me yndyrë bimore (vaj palme).
2. Ndalohet përkohësisht përdorimi i vajit të palmës në prodhimin e produkteve të ngjashme të djathit nga prodhuesit vendor.
3. Obligohet Dogana e Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.
4. Obligohet Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës të bëjë hulumtim lidhur me përdorimin e brendshëm të vajit të palmës.
5. Obligohet Inspektorati i Tregut i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë të obligojë operatorët ekonomikë të bëjë ndarjen e produkteve të qumështit me yndyrë bimore (vaj palme) prej atyre me origjinë shtazore.
6. Vendimi hyn në fuqi me datën 15.09.2020.

ARSYETIM

Duke u bazuar në kërkesën e Shoqatës së Industrisë së Qumështorëve të Kosovës (SHIQK) dhe Shoqatës së Prodhuesve të Qumështit të Kosovës (SHPQK) të datës 10.06.2020, si dhe shqetësimet e ngritura nga Odat ekonomike dhe nga ana e konsumatorëve, dhe referuar të dhënave statistikore të Agjencisë së Statistikave të Kosovës lidhur me importin e vajit të palmës për periudhën 2015-2019, vërehet rritje e konsiderueshme e importit të vajit të palmës, respektivisht në vitin 2015 importi sipas peshës neto ishte 1,866,165 kg/litër kurse në vitin 2019 ishte 3,488,700 kg/litër, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe

Zhvillimit Rural dhe Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë vlerëson se vaji i palmës (yndyra bimore) dyshohet se po përdoret për prodhimin e produkteve të qumështit dhe në etiketën e produkteve të qumështit nuk vendosen të dhëna të sakta lidhur me përmbajtjen e produktit, prandaj konsiderojmë që me këtë rast është duke u dëmtuar konkurrenca e lirë dhe ka elemente të mashtrimit të konsumatorit. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin Nr.03/L-016 për Ushqimin dhe Ligjin Nr.06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit.

Po ashtu duke pasur parasysh se mbetet që të hartohet dhe miratohet Rregullorja për përcaktimin e standardeve për përdorimin e brendshëm të vajit të palmës dhe AUV-it dhe Inspektorati i Tregut do të vazhdojnë të marrin mostra të produkteve të qumështit me qëllim të kryerjes së analizave lidhur me përmbajtjen e këtyre produkteve (për prezencë të vajit të palmës dhe deklarimit në etiketën e produktit), prandaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vesel KRASNIQI

Ministër



Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryeministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- MBPZHR-së;
- AUV-it;
- Doganës së Kosovës;
- Inspektoratit të Tregut;
- Departamentit të Tregtisë;
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit të MTI-së.